



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.06.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
2. Projektligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja dhe Vexhi Muçmataj.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Keltis Kruja, Fatmir Mediu dhe Spartak Braho

Të ftuar:

Gent Ibrahimimi, ekspert i Nivelit të Lartë

Agnes Bernhard, eksperte e Nivelit të Lartë, zëvendëseshfe e Misionit EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj - Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar të Reformës në Drejtësi sipas kalendarit të miratuar nga ky komision, lidhur me shqyrtimin dhe votimin e projektligjeve prioritare në Komisionin e Posaçëm Parlamentar të Reformës në Drejtësi.

Sot, kemi në rendin e ditës, sipas këtij kalendarit, dy projektligje. Projektligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe projektligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligj aq i shumëpritur dhe që hartohet për herë të parë në Republikën e Shqipërisë.

Të dyja janë projektligje të reja, janë projektligje që reflektojnë ndryshimet e reja kushtetuese dhe njëkohësisht i përgjigjen konceptit të ri të organizimit të sistemit të drejtësisë, të pushtetit gjyqësor dhe atij të prokurorisë. Sot kemi shqyrtimin në parim ose më saktë, që të jem akoma më korrekt, një prezantim të dy projektligjeve, për të dëgjuar nga ekspertët që përfaqësojnë dhe që kanë drejtuar praktikisht grupin, ndoshta më të rëndësishëm të të gjithë grupeve të ekspertëve të nivelit të lartë vendas dhe ndërkombëtar që janë përfshirë në këtë proces. Kemi këtu të pranishëm dy bashkëkryetarët, zonjën Agnes Bernhard, e cila është njëkohësisht edhe zëvendësshefe e misionit EURALIUS, dhe nuk do të lodhem asnjëherë ta them, që jo vetëm unë që kam punuar me të, por edhe të gjithë ekspertët që kanë punuar me të kanë vlerësimet maksimale për marrëdhënien dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer që ka pasur me ekspertët shqiptarë, por, edhe për punën e jashtëzakonshme që ka bërë në gjithë këtë proces, si dhe bashkëkryetarin, zotin Gent Ibrahimi, të cilit i është dashur të mbajë mbi shpatulla një përgjegjësi të veçantë, që ka të bëjë me hartimin e legjislacionit në fushën e gjyqësorit, që siç e thashë është një nga shtyllat bazë dhe është përcaktuese e gjithë këtij procesi reformues të sistemit të drejtësisë. Unë dua ta vlerësoj atë, për qetësinë, maturinë dhe skrupolozitetin e treguar në gjithë këtë proces, sepse i është dashur të bashkojë apo të sjellë në një mendim të përbashkët shumë mendje, që ndodh radhë ndër ne juristët.

Natyrisht, janë këtu në krah të tyre edhe dy zonjat, të cilat kanë punuar në cilësinë si eksperte të sekretariatit teknik dhe kanë kontribuar, së bashku me ekspertët e nivelit të lartë për ta formësuar të gjithë këtë produkt. Natyrisht, si zonja Bernhard, si zoti Ibrahimi, ashtu edhe dy zonjat e sekretariatit teknik janë përfaqësuese të një grupi të gjerë njerëzish që kanë punuar me këto projekte dhe është momenti për t'i vlerësuar të gjithë ata, për këtë punë

voluminoze, shumë serioze, me shumë përkushtim që kanë bërë me orë e orë të tëra, përfshi edhe fundjavat shpeshherë dhe këta janë përfaqësuesit e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, janë dy përfaqësueset e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përfaqësues nga Gjykata e Lartë, përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme gjithashtu, që njëkohësisht edhe kjo tregon përfshirjen e të gjithë aktorëve të sistemit në këtë proces.

Por më konkretisht le të fillojmë me paraqitjen e dy projekteve. Fillimisht me paraqitjen e projektligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor dhe më pas me projektligjin për statusin. Natyrisht, do të kishim interes për një paraqitje të përmbledhur, sepse janë edhe relacionet. Do të dëshiroja të theksonit, cilat janë risitë kryesore të këtyre dy projektligjeve, përputhshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare dhe kryesisht me ato të BE-së.

Së treti, sa e ruajnë ato traditën dhe sa e zhvillojnë atë, traditën që kemi sot në sistem.

Së katërti, diçka për metodologjinë e gjithë këtij procesi.

Nuk e di se cili prej jush do të filloj në lidhje me projektligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”.

Zonja Bernhard!

Agnes Bernhard – *(flet anglisht)* Do të doja ta filloja me një prezantim të shkurtër, për pjesën që keni miratuar dhe pastaj zoti Ibrahim do të vazhdoj me pushtetin e gjyqësorit, ndërsa unë do të prezantoj draftin e projektit.

Faleminderit kryetar!

Faleminderit anëtarëve që na kanë ftuar në këtë takim!

Unë flas edhe në emër të anëtarëve të tjerë të grupeve të punës, të cilët nuk do të jenë në gjendje të vijnë në të gjitha takimet e posaçme, por do të përpiqen të jenë të pranishëm sa më shumë të jetë e mundur dhe të jenë në koherencë me punën tonë.

Të gjitha këto projektligje i kemi përpunuar me një punë intensive dhe serioze, për më shumë se 8 muaj. E kemi filluar tetorin e vitit të kaluar dhe ende nuk e kemi përfunduar, por jemi në punë e sipër edhe sot e kësaj dite.

Kemi kaluar në 5 faza kryesore. Kemi filluar me një periudhë 2-mujore, ku e kemi përpunuar këtë ligj nen pas neni. Kjo fazë u ndoq dhe u kombinua me një fazë takimesh midis grupeve *think tank*, ku kanë qenë të pranishëm edhe ekspertë nga opozita dhe një gamë e gjerë e grupeve të interesit, të cilët morën pjesë aty. Gjithashtu, kemi pasur dhe kemi marrë një sërë komentesh nga gjyqtarët anëmbanë vendit dhe më pas kjo fazë u ndoq me një ushtrim rishikues i bërë nga grupet e punës, ku pamë dhe studiuam secilin nga komentet dhe vendosëm nëse do t’i përfshinin komentet në ligj dhe në qoftë se jo, ne përcaktuam një tabelë edhe arsyet pse i ndoqëm dhe nuk i përfshimë këto komente. Më pas, përsëri këto projektligje

ua dërguam grupeve *think tank*, grupeve të ndryshme të interesit, avokatëve dhe prokurove dhe patëm dy konsultime publike ku përsëri morëm komentet *feed back*. Kështu pas kësaj faze ne përsëri bëmë një proces rishikues shumë intensiv, ku si grup pune u mblodhën dhe i pamë komentet njëri pas tjetrit. Gjithashtu, e rishikuam të gjithë projektligjin për ta sjellë në linjë me ndryshimet kushtetuese që u zhvilluan gjatë kësaj periudhe. Rezultatet janë këto dy drafte që kemi sot. Sigurisht që këto janë rezultatet e këtij procesi dhe ajo çka është e shkruar këtu shpreh opinionet kryesore që kanë pasur anëtarët. Aty-këtu nuk është se kemi pasur opinione mbizotëruese, kemi pasur ndoshta dy opinione, të cilat mund të kenë qenë të dyja të mundshme dhe më pas vendimi u morr nga grupet e punës, të cilët kanë dhënë mendimin kryesor dhe kanë rënë dakord për mendimin kryesor, kurse mendimin tjetër e kanë lënë me anë të një *footnote* poshtë si formë shpjeguese. Kjo ishte diçka për procesin. Tani do t'i kërkoja zotit Ibrahimimi, të bënte prezantimin e projektligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”.

Ju faleminderit!

Gent Ibrahimimi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit zotërinj deputetë!

Faleminderit, Agnes!

Sot, siç e thatë edhe ju, do fillojmë shqyrtimin e dy projektligjeve themelore për mënyrën se si organizohet dhe funksionon sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Risia e parë, e madhe, që besoj se është e thjeshtë për t'u vënë re nga të gjithë, është organizimi i lëndës, organizimi i çështjeve të gjyqësorit në tre ligje të mëdha: Ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”, ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe ligji “Për organet e qeverisjes të pushtetit gjyqësor”. Një vështrim i thelluar i legjislacionit aktual në lidhje me këto çështje të shpie shpejt në përfundimin se legjislacioni aktual ka një përzierje konceptesh. Për shembull, në ligjet që janë të supozuara të jenë ligje organizative gjen elemente që kanë të bëjnë me statusin e magjistratëve, pra mënyra se si emërohen magjistratët, si ecin përpara në karrierë, si disiplinohen ata e kështu me radhë. Pra, ka një shpërndarje të lëndës në mënyrë jo logjike dhe në mënyrë jo të përshtatshme për leximin dhe zbatimin e legjislacionit, kështu që ushtrimi i parë që është bërë nga grupi i punës së gjyqësorit është qëmtimi dhe vendosja e çështjeve nën një kësulë, nën një çati që i rri mirë. Pra, çfarë ka të bëjë me statusin, me emërimin, me promovimin, me pagat, me trajnimin, të gjitha këto çështje mblidhen nën një çati të vetme, çështjet që kanë të bëjnë me organizimin e gjykatave nën një çati më vete; çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën se si qeveriset pushteti gjyqësor nën një çati më vete. Ajo çka unë do të përpiqem të shpjegoj shumë shkurt sot duke

u ndalur në ato tri çështjet kryesore që përmendi zoti Xhafaj, do të jetë ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”.

Titulli e tregon qartë që ky është një ligj që ka për objektiv të rregullojë organizimin e gjykatave në këtë vend, për pasojë në brendinë e atij ligji mund të gjenden çështje të tilla, si: përcaktimi i kompetencës tokësore të gjykatave, pra ku e shtrijnë gjykatat juridiksionin e tyre, rregullin për caktimin e seksioneve në gjykata, rregullat për caktimin e përbërjes së trupave gjyqësore, rregullat për hartën gjyqësore, rregullat për organizimin e brendshëm në gjykata, rregullat për funksionimin e administratës gjyqësore, si dhe statusin e punonjësve në gjykatë. Besoj ju kujtohet që kjo çështja e fundit ka qenë jetime për një kohë të gjatë në Shqipëri. Pra, statusi i nëpunësve gjyqësorë është krejtësisht i pakënaqshëm dhe nuk është kurrsesi në lartësinë e rëndësisë së detyrave të tyre. Me këtë ligj këtij problemi i jepet një zgjidhje themelore. Unë besoj, si rezultat i këtij ligji, në të ardhmen, pozicioni i nëpunësit civil të gjykatave do të jetë më i respektuar, më i organizuar dhe më i efektshëm në ushtrimin e detyrave të tij.

Në përgjithësi projektligji përkon me linjat e mëdha të përcaktuara nga Kushtetuta. Do të vëreni një theksim të rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe një dobësim të rolit të ministrit të Drejtësisë. Kompetencat që kanë të bëjnë me administrimin e gjyqësorit tashmë janë nën Këshillin e Lartë Gjyqësor, siç do të quhet ai pas hyrjes së tij në Kushtetutë.

Në lidhje me përcaktimin e kompetencave tokësore dhe me madhësinë e gjykatave, projektligji ka disa risi të rëndësishme. Risia më e dukshme është një prirje për krijimin e gjykatave të mëdha. Eksperienca botërore, por edhe ajo shqiptare sugjeron që gjykatat e mëdha janë më të efektshme në punën e tyre, për pasojë qytetarët arrijnë të marrin drejtësi më të mirë, më shpejt nga gjykatat e mëdha. Natyrisht që pyetja është çfarë është një gjykatë e madhe, apo e mesme, apo e vogël. Gjithmonë, eksperiencat e krahasuara, sugjerojnë që një gjykatë me diçka midis 40-80 gjyqtarëve është një gjykatë, e cila është optimale për nga eficienta e lëvrimit të shërbimeve. Kjo është njëra anë e medaljes.

Ana tjetër është që gjykatat do t'i përqendrosh, aq sa është e mundur, në mënyrë që ato të funksionojnë mirë, por ama pa cenuar aksesin e përdoruesve të gjykatave, pra pa cenuar aftësinë e tyre për të shkuar në gjykatë fizikisht, shpejt dhe për të marrë një shërbim brenda një kohe të arsyeshme. Kështu që në këtë projektligj ju nuk do të shikoni një hap kaq drastik, pra një propozim që gjykatat e Shqipërisë të kenë një numër minimal prej 40 gjyqtarësh. Kjo do të komprometonte thellësisht aksesin. Sidoqoftë, ky projektligj vendos disa kritere, të cilat duhet të mbahen parasysh nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në përcaktimin e madhësisë së gjykatave.

Një çështje tjetër e rëndësishme që është, gjithashtu, risi, janë kompetencat. Pra, kompetencë e kujt do të jetë përcaktimi i kompetencës tokësore të gjykatave? U ktheva prapë te çështja e kompetencës tokësore të gjykatave. Nuk është se ka ndonjë standard uniform në Europë, në lidhje me këtë çështje. Disa zgjidhje janë të mundshme, kështu, për shembull, një zgjidhje është Kuvendi, të jetë me ligj ai që përcakton kompetencën tokësore të gjykatave. Problemi i kësaj është evident sidomos në Shqipëri, ku ligjet në lidhje me gjyqësorin miratohen me shumicë të cilësuar. Problemi, është rigjiliteti, ngurtësia.

Nga ana tjetër, ne kemi traditën e caktimit të kompetencës tokësore të gjykatave me dekret të presidentit. Ky projekt propozon të ruhet kjo traditë, por me një dallim të rëndësishëm, i cili është që përgjegjësia e vërtetë i lihet në dorë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili supozohet të bëjë një propozim të bazuar mbi studimin e trendeve afatgjata, zhvillimeve demografike, të infrastrukturës politike - administrative e të tjera. Të gjitha këto duhet të jenë në themel të propozimit që do të bëjë Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili do të ngurtësohet me një dekret të Presidentit.

Projektligji përveçse alokon përgjegjësinë për caktimin e hartës gjyqësore, është kjo që unë thashë, dekreti i Presidentit, por mbi bazën e një propozimi të mirëstudiuar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, jep edhe kriteret që duhet të ketë parasysh Këshilli i Lartë Gjyqësor në përgatitjen e propozimit të tij. Këto janë pak a shumë ato që përmenda më sipër: garantimi i aksesit të papenguar në drejtësi; ulja e kostove; si dhe rritja e efektivitetit në lëvrimin e shërbimit gjyqësor.

Për sa i takon madhësisë së gjykatave, është çështja që përmenda pak më parë, projekti propozon që në përbërje të gjykatave të shkallës së parë të ketë, së paku, 7 gjyqtarë. Është dhënë një alternativë e dytë, që ky numër të jetë jo 7, por 12. Kudo ku shikoni alternativa, do të kuptoni, siç tha edhe zonja Bernhard pak më parë, që në grupin e punës ka pasur këndvështrime të ndryshme dhe në pamundësi për të konvertuar në një mendim, janë dhënë të dyja. Ndërsa për gjykatat e apelit propozohet të ketë një numër minimal prej 10 gjyqtarësh, ose 15 në *footnote*.

Për sa i takon madhësisë së gjykatave, besoj se ky projektligj përkon me një prirje shumë të qartë panevropiane, për zmadhimin e gjykatave, gjithmonë duke pasur parasysh përvojën tashmë të konsoliduar që një gjykatë e madhe arrin të jetë më e efektshme në ofrimin shërbimeve.

Një tjetër risi e rëndësishme e projektligjit është ideja për krijimin e degëve të gjykatave. Natyrisht që krijimi i degëve është një zgjidhje e detyruar, nëse shkohet në drejtim të përqendrimit të gjykatave dhe zmadhimit të tyre. Pikërisht për të mos komprometuar të

drejtën e aksesit, del pothuajse e detyruar ideja të krijohen disa degë të gjykatave. Degët e gjykatave zgjidhin disa probleme njëherësh. Problemi i parë dhe më evident që ata zgjidhin është zbutja e problemit të aksesit pasi është bërë përqendrimi i gjykatave.

Problemi i dytë që ata zgjidhin është një lloj zhdërvjelltësie në caktimin e gjyqtarëve nëpër degë, sepse këto do të jenë çështje që do të rregullohen së brendshmi nga vetë gjykata pra, nuk do të jetë nevoja të përfshihet Këshilli i Lartë Gjyqësor në marrjen e vendimeve për dërgimin e një gjyqtari pranë një dege, por është Këshilli i Gjykatës, i cili, në mënyrë shumë praktike, organizon shërbimin gjyqësor në degën e gjykatës, që është në varësi të gjykatës qendrore.

Edhe nga pikëpamja e kompetencës lëndore, puna e degëve do të jetë e kufizuar. Degët e gjykatave do të shqyrtojnë vetëm çështje jo urgjente, të cilat normalisht janë në kompetencën e një gjyqtari të vetëm.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i projektit besoj se është parashikimi i rregullave në lidhje me caktimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve. Edhe në këtë rast, vendimmarrja do të udhëhiqet nga po ato kritere që kanë të bëjnë me caktimin e numrit të gjykatave, pra: aksesit dhe efektiviteti. Ideja është se roli kryesor në përcaktimin e përgjithshëm të gjyqtarëve t'i lihet Këshillit të Lartë Gjyqësor. Këshilli i Lartë Gjyqësor e propozon numrin e përgjithshëm të gjykatave, bashkë me propozimin për buxhetin vjetor, duke qenë i qartë që numri i gjyqtarëve ka implikim të drejtpërdrejtë në buxhet. Vendimmarrja është vetiu e Kuvendit, sepse Kuvendi, duke pranuar propozimin për buxhet të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka pranuar rritjen dhe teorikisht edhe zvogëlimin numrit të gjyqtarëve. Pra, vendimmarrja mbetet e Kuvendit, natyrisht, por propozimi vjen në këtë formë, vjen bashkë me projektbuxhetin, me atë projektbuxhet që, nëse kanë qenë 350 gjyqtarë në vitin 2016, projekti i vitit 2017 parashikon 370 gjyqtarë. Pra, propozimi vjen në këtë formë dhe vendimmarrja bëhet përmes votimit të ligjit të buxhetit.

Sa i takon organizimit të brendshëm të gjykatave, ligji parashikon ... brenda për brenda gjykatës. Këtu natyrisht do të kemi përsëri kryetarin, zëvendëskryetarin dhe kancelarin, por kemi edhe një risi të rëndësishme që është këshilli i gjykatës, i cili është një trupë kolegjiale i përbërë nga kryetari, zëvendëskryetari dhe nga kancelari. Është kjo një përprjekje për të pajtuar dhe për t'i dhënë më efektivitet bashkimit, konvertimit të aspektit gjyqësor me aspektin menaxherial në punën e një gjykate. Të gjithë jemi dëshmitarë që për shumë kohë ka qenë problem ndarja midis aspekteve të punës së gjyqësorit. Shpresojmë që përmes këshillit të gjykatës, i cili sjell të gjithë aktorët në kupolë, ky problem të marrë një zgjidhje.

Së fundi, do të përmendja atë që thashë pak më sipër, në lidhje me statusin e nëpunësit civil. Ky projektligj parashikon një status të plotë kompleks për nëpunësit civilë gjyqësorë. Ai është një propozim që është në një masë të madhe i ngjashëm, analog me rregullimin që i bën ligji i shërbimit civil nëpunësit civil dhe besojmë që në këtë kemi sjellë një propozim të rëndësishëm që do të ketë efekt të drejtpërdrejtë në cilësinë e punës në gjykata.

Pra, kur them cikli i plotë, kam parasysh rregullat për mënyrën e trajnimit, rekrutimit, avancimit në karrierë, të statusit të tyre. Për sa i takon pagës, disiplinimit, gjithçka është rregulluar në detaj. Kemi praktikisht një shërbim civil paralel, pra, kësaj radhe kemi një shërbim gjyqësor.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Do t'i dëgjojë të dyja, apo veç e veç?

Po, dakord.

Atëherë, a ka pyetje?

Zonja Hysi, që ka njëkohësisht edhe përgjegjësinë e të qenit relatore për këto projektligje, do të fillojë me pyetje.

Para se të fillojë zonja Hysi, kam një pyetje në parim, zoti Ibrahim, për ekonomi të përdorimit të tekstit dhe për lehtësi, pse nuk i kemi bashkuar në një të vetme edhe ligjin për organizimin gjyqësor, edhe statusin, nuk do të gaboja po të thosha edhe organet e qeverisjes? Pse duhet t'i ndajmë në tri ligje të veçanta? A nuk mund t'i përfshijmë në një të vetëm, që të jenë unikë, në mënyrë që të ketë koherencë në tekst edhe në ndërhyrjet e mëpasshme që bëhen për efekt referencash, për efekt ndryshimesh, në mënyrë që të mos ndryshojmë të gjithë ligjin?

Kjo është pyetje në parim, e cila ka marrë rrugë dhe nuk e di sa oportune dhe e mundshme është nëse do të pranohet si ide.

Së dyti, kur trajtuat çështjen e hartës gjyqësore, e cila zë një vend të rëndësishëm të organizimit në projekt, keni parë vetëm një rrugë. Ju e lidhni këtë me 3/5 në rolin e parlamentit, ashtu siç ligji mundet ta parashikonte që me një shumicë të thjeshtë, rrua parlamentare me argumentet që sillni ju është shumë e vështirë, sepse kërkon një shumicë të cilësuar etj..

Mua më shqetëson roli i ministrit të Drejtësisë, si përfaqësues i ekzekutivit. Për sa kohë në këtë lloj akti, në këtë lloj ndërmarrjeje përfshihen elementë shumë të fortë ekzekutivë, që përgjithësisht kanë një pjesë të mirë të barrës jo thjesht për ta ndërtuar, por

edhe për ta organizuar e zbatuar i takon ekzekutivit në finale dhe është një bashkëndarje përgjegjësie kjo pjesë, a nuk do të ishte më mirë që të kishim një akt/propozim të përbashkët, sepse Këshilli sot mund ta marrë në konsideratë ose jo, mund të gjykojë i shkëputur nga interesat e përgjithshme që ka vendi në një moment të caktuar, nga përgjegjësitë që ka qeveria për buxhetin për situatën financiare etj., etj.? Prirja është vetvetiu që ndodh, si edhe e kundërta, pra nuk do të ishte më mirë të ishte një bashkëpropozim midis Ministrisë Drejtësisë dhe Këshillit? Ju do të më thoni menjëherë: po nëse këta nuk bien dakord? Atëherë Këshilli ia çon parlamentit versionin e vet, opsioni i dytë ky në qoftë se ata bien dakord, ministri i Drejtësisë me Këshillin, Presidenti natyrisht ka një akt të natyrës formale. Ndërsa, në rast se nuk bien dakord dhe ka një problem, atëherë le të investohet parlamenti për ta debatuar dhe çdo vendim i parlamentit më pas krijon efekte dhe është urdhërues për ekzekutivin.

Do të dëshiroja të dëgjoja më qartë idenë e degëve të gjykatave, sepse është një përzierje midis asaj që kemi traditë dhe një gjëje krejt të re që duam të fusim në sistem. Sa mund të rrinë bashkë ato dhe cilat mund të jenë risqet? Është gjë pozitive përqendrimi i gjykatave. Ka edhe një propozim të ministrit aktual të Drejtësisë që konvergojnë bashkërisht në këtë pikëpamje, e kam diskutuar me të disa herë për të përqendruar numrin e gjykatave, kjo është e drejtë dhe i shkon kësaj logjike. Por, duke qenë se është risi dhe pak e fortë për traditën tonë, cilat janë risqet në këtë fazë të procesit?

Ne na shqetëson shumë kufizimi i aksesit dhe është shumë e rëndësishme që degët ta ndihmojnë aksesin e qytetarit, të ndihmojnë efektivitetin, përqendrimin e punës të gjykatave që të jenë ndihmuese nga njëra anë dhe nga ana tjetër edhe për aksesin, sepse ne jemi përfaqësues të popullit dhe është pjesë e raportit që ne kemi me zgjedhësit. Duhet të kuptohemi edhe në këtë aspekt.

Gent Ibrahimi - Në lidhje me idenë tuaj, në qoftë se mund të huazoj terminologjinë tuaj ekonomike, legjislative, pra që t'i mbledhësh të gjitha këto projekte në një akt të vetëm legjislativ, po, është diskutuar kjo, madje fillimisht kjo ishte ideja që do të prevalonte në fund që të kishim një akt të vetëm legjislativ, madje është qarkulluar edhe ideja që pjesë e këtij akti të vetëm legjislativ të ishte edhe ligji për Shkollën e Magjistraturës duke qenë se, edhe ai ka të bëjë me një nga institucionet e qeverisjes së gjyqësorit.

Mendoj që ne nuk i kushtuam shumë kohë, sepse puna u nda në tre grupe në mënyrë të natyrshme dhe, pasi u futëm në hullinë e punës, nuk është se e menduam më, pa dyshim do të thosha se nuk ka ndonjë problem në rast se këto grupohen për hir të kodifikimit, askush nuk besoj ta vërë në dyshim mençurinë dhe nevojën që ka gjithmonë legjislacioni për kodifikim, por fare mirë të gjitha këto mund të sillen në një produkt të vetëm, megjithatë dua

të dëgjoj edhe komentim e Agnes në këtë pikë. Për sa më takon, besoj që mundësia për t'i unifikuar në një ligj të vetëm nuk paraqet ndonjë problem.

Për sa i takon çështjes së hartës gjyqësore, shpjegimi ynë do të ishte që, nëse do ta linim me ligj, do të paraqitej problemi i shumicës. Këtu ka një paqartësi, sepse pa dyshim ky ligj, është ligj kuadër, i cili përcakton kriteret mbi bazën e të cilave përcaktohet harta gjyqësore, dhe që do të jetë me 3/5, por nëse do të kërkohet po kjo shumicë për një ligj tjetër i cili praktikisht vizaton hartën gjyqësore apo do të duhet një shumicë më e vogël, për këtë nuk jam shumë i sigurt. Këtu mendoj që ndoshta mund të bëhet dallimi midis këtij ligji që është ligj kuadër për organizimin e pushtetit gjyqësor dhe si i tillë do të miratohet me 3/5, dhe ndoshta një ligj tjetër, i cili në mënyrë periodike merr vendimin për vizatimin e hartës gjyqësore. Ky mund të ishte një ligj që miratohet me shumicë të thjeshtë, praktika e krahasuar tregon se ligjet që vendosin hartat gjyqësore të vendeve të caktuara, janë ligje me shumicë të thjeshtë. Për çështje të tjera, do t'ia lë fjalën zonjës Bernhard, edhe në lidhje me rolin e ministrit ndoshta....

Agnes Bernhard - *(flet anglisht)* Do të doja të shtoja një koment në lidhje me pyetjen nëse mund t'i bashkojmë këto tre ligje në një akt të vetëm. Mendoj se është praktike, patjetër, mund të kesh një ligj të madh në sistemin e drejtësisë, por, gjithashtu, duhet të kemi parasysh se këto tre ligje përfshijnë pjesërisht edhe sistemin e prokurorisë. Nëse shkoni me këtë logjikë, mendoj se do t'u duhet të përfshini edhe ligje të tjera si përshembull ligji për prokurorinë apo ligjin e SPAK-ut, nëse do të donit të kishit kështu në këtë mënyrë një libërth të konsoliduar për sistemin e drejtësisë. Në anën tjetër, kemi ligjet e gjyqësorit me disa aspekte si Këshillin e Prokurorisë e kështu me radhë.

Ndërkohë që ligjet për prokurorinë mbeten të veçanta, pra nëse ecim me këtë logjikë, do t'i kemi ligjet e ndara, pa përfshirë prokurorinë këtu.

Në lidhje me shumicën, me 3/5, një nga argumentet që na çuan në këtë zgjidhje kishte të bënte me vendimet e Gjykatës Kushtetuese për ligjin "Për administrimin e gjyqësorit", i cili nuk shkon me miratimin e shumicës së 3/5, kështu që menduam që Kushtetuta do të donte një ligj për hartën e gjyqësorit me të njëjtën logjikë duke mbajtur 3/5, duke ruajtur kështu një standard shumë të lartë për hartën e gjyqësorit, por që sigurisht ju mbetet juve në dorë për ta pasur parasysh si do ta shqyrtoni, si do ta ruani këtë argument.

Në lidhje me rolin e ministrit të Drejtësisë, në hartën e gjyqësorit, në fakt, kjo u diskutua edhe në grupet e punës dhe sigurisht Ministria e Drejtësisë dhe ekzekutivi duhet të përfshihen, sepse në fund të ditës, organizimi i hartës së gjyqësorit ka një impakt të fortë mbi buxhetin dhe kështu është një çështje që duhet rregulluar nga qeveria. Ne, gjithashtu, kemi

kërkuar që, në qoftë se kemi një bashkim të akteve për Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin e Gjyqësorit, ky shpirt i bashkëpunimit nuk është shumë i lartë, mund të ndodhë që të kemi një bllokim, prandaj ky projektligj parashikon përgjegjësitë kryesore me Këshillin e Lartë të Gjyqësorit në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe të kemi mendimin e ministrit të Drejtësisë, si edhe të prokurorit të Përgjithshëm nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, nga Policia Gjyqësore, për të pasur një pikturë të përgjithshme përpara se të dalim me një propozim përfundimtar. Sigurisht do të ishte në përputhje me standardet ndërkombëtare nëse do të kishim një bashkëpunim më të ngushtë midis ekzekutivit dhe sistemit të gjyqësorit. Megjithatë, ne kemi mbajtur parasysh edhe opinionet e Komisionit të Venecias të cilët kanë kërkuar që Këshilli i Lartë i Gjyqësorit duhet të luajë një rol më të lartë në këtë proces.

Për aspektin e tretë, për degët, në fakt, kjo ka qenë një problematikë goxha e diskutuar në grupet e punës dhe arsyetimi përse ky draft tashmë propozon ose hap mundësinë për të themeluar degët e gjykatave, ka të bëjë me pikën që është kryetari ai që e përcakton këtë gjë. Na duhet të gjejmë një balancë për aksesin në drejtësi, dhe, nga ana tjetër, nevojën për të përdorur fondet publike në mënyrë sa më efektive që të jetë e mundur për të pasur një punë sa më cilësore të gjyqësorit. Nëse shohim vetëm për fondet e buxhetit dhe shpërndarjes/ofrimit efikas të shërbimeve të gjyqësorit, mbërrijmë në konkluzionin që gjykatat duhet të kenë të paktën 40 gjyqtarë. Për Shqipërinë ky do të ishte një standard shumë i lartë dhe kjo është shumë e qartë. Në këtë draft, ne propozuam të paktën 7 gjykatës nga 10 në Gjykatën e Apelit, këtë mund ta keni lexuar te propozimi, sepse, në fakt, ka qenë shumë e debatuar te grupet tona të *think tank*. Disa nga ekspertët tanë kanë thënë që kjo nuk është e mjaftueshme për të garantuar efikasitetin dhe ata propozuan një numër më të lartë minimal të gjykatësve për gjykatë. Një opsion alternativ mund të jetë në përputhje me raportin e CEPEJ-it për të pasur të paktën 10 anëtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe të paktën 15 anëtarë në Gjykatën e Apelit.

Nëse shkoni me këtë numër minimal të gjykatësve për gjykatë, atëherë keni riskun që në një vend si Shqipëria, me shumë male dhe zona të largëta, disa qytetarë mund të mos kenë mundësi të kenë mjete publike që të shkojnë në gjykata, të marrin pjesë në proces dhe të kthehen brenda ditës në shtëpinë e tyre dhe kjo është pjesë e problemit tonë. Për ta lehtësuar këtë, ne menduam se duhet të përcaktojmë me ligj të paktën mundësinë për të pasur edhe këtu dy degë të gjykatave. Ligji parashikon dy mundësi për degët e gjykatave.

E para, është mundësia për degë të përhershme të gjykatave, ku paracaktohen kriteret me të paktën tre gjyqtarë, pra “nëse”. Gjithashtu, këta tre gjyqtarë nuk duhet të kenë çështje gjyqësore më të ulëta sesa kanë pasur gjyqtarët në Shqipëri gjatë 3 vjetëve të fundit.

Pra, në zonat ku ka degë të përhershme dhe çështjet janë të vogla, ne krijojmë disa gjykata të përkohshme, ku dy gjyqtarë shkojnë dy herë në javë atje për të dëgjuar çështjet, por ata operojnë, veprojnë në gjykata kryesore, duke pasur asistencën e stafit që gjendet në degët e gjykatave të përkohshme. Kjo mundësi që kemi parashikuar me ligj mund të përdoret sa më pak të jetë e mundur, sepse është një mënyrë më pak efektive, përdor fonde, por në të njëjtën kohë është e nevojshme që të jenë gjykatat e mëdha për të lehtësuar efektin e risqeve, për të mos pasur akses në drejtësi.

Pra, nëse në njërin krah i referoheni çështjes së efikasitetit dhe në krahun tjetër lehtësimit të aksesit në gjykata, u japim një drejtim këtyre dy shqetësimeve dhe, gjithashtu, i japim një fleksibilitet për zhvillimin më tej. Pra, nëse do të kishte një tunel, për shembull, për zonat e thella të Matit, ne do ta kishim të thjeshtë të vinim, por njerëzit e kanë të vështirë të vijnë në Tiranë pa transportin publik. Kështu që do të ishte më mirë që të kishim një degë, qoftë edhe të përkohshme, në zonën e Matit për të lehtësuar aksesin e njerëzve në gjykatë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit edhe për shpjegimet, edhe për faktin që jeni familjarizuar me zonën e Matit dhe kjo tregon shumë, mund të rrimë më të qetë, sepse këtu ka edhe deputetë që janë përfaqësues të atyre zonave! Bëtë mirë që e morët si shembull.

Faleminderit për përgjigjet!

Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Më lejoni, para së gjithash, të falënderoj të gjithë ekspertët dhe të gjithë ata që kanë dhënë mendime dhe sugjerime për këtë projektligj gjatë fazës së konsultimit publik!

Ne sot kemi dy ligje voluminoze. Për mendimin tim, që të dy ligjet janë risi, pavarësisht se ne kemi pasur një ligj “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”. Ky ligj ka risi dhe sjell një qasje tjetër për mënyrën e organizimit të brendshëm të gjykatave, por edhe të të gjithë sistemit në tërësi.

Në cilësinë e relatores do të doja të bëja disa pyetje për të qartësuar jo vetëm veten time, por edhe lidhjen e këtij ligji me dy ligjet e tjerë: me statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit në Republikën e Shqipërisë dhe me ligjin për organet dhe qeverisjen e gjyqësorit.

Në parim mendoj që këto ligje të jenë të veçanta, sepse janë voluminoze dhe trajtojnë aspekte të ndryshme, përndryshe ne do të kemi një ligj libër, shumë të madh dhe të vështirë për t’u menaxhuar.

Pyetja e parë ka të bëjë me risinë, me krijimin e degëve. Mua më pëlqen ideja që gjykatat të jenë më efektive, por, nga ana tjetër, duhet të jemi shumë të vëmendshëm për

eksesin e qytetarëve. Në këtë kuadër, fakti i krijimit të degëve të përkohshme të këtyre gjykatave, a e dëmton reputacionin dhe solemnitetin e dhënies së drejtësisë?

Pyetja e dytë ka të bëjë me kompetencën lëndore të degëve të këtyre gjykatave. Genti e pasqyroi dhe e prezantoi shumë mirë pse krijohen këto degë, degët e përhershme ose të përkohshme, por nga leximi i kompetencave të degëve më rezultoi përdorimi i fjalëve “çështje urgjente”. Pra, cilat janë çështjet urgjente që janë në juridiksion të këtyre gjykatave? Diku në relacion dalin fjalët që “kompetencë lëndore e këtyre gjykatave janë kontratat e blerjes, por jo të pronësisë, të familjes dhe të punësimit”. Fjala është që këto gjykata do të kenë vetëm kompetenca në çështje civile, apo edhe në çështjet penale? Nëse do të kenë në çështjet penale do të jenë kundërvajtjet, apo edhe krimet që kanë një peshë specifike të vogël? Në këtë pyetje unë kam parasysh përvojën që kemi pasur para viteve '90 me gjykatat e fshatrave, qyteteve dhe lagjeve.

Pyetja e tretë ka të bëjë me rolin ose me mënyrën se si do të gjykojnë gjykatat ose degët e gjykatave. Mua më krijohet përshtypja se po krijohen gjykata që do të bëjnë më tepër ndërmjetësim, ose do të zbatojnë drejtësinë restauruese. E pëlqej jashtëzakonisht shumë qasjen që do të ketë drejtësi restauruese më shumë, por çfarë do të bëhet me shërbimin e ndërmjetësimit, që ne e kemi aktualisht të rregulluar me ligjin “Për ndërmjetësimin”? Këto degë do të bëjnë ndërmjetësim dhe, në rast se palët nuk bien dakord për shqyrtimin e çështjes në këtë nivel, do të shkojnë te gjykata kryesore, apo e kam kuptuar unë gabim?

Kërkoj ndjesë, Genti, mund t'i bëj të gjitha pyetjet dhe më pas të përgjigjeni?

Gent Ibrahimi – Po.

Vasilika Hysi - Gjithashtu, kam një pyetje për specializimin e gjykatave. Në gjykata krijohen seksione civile penale dhe një nga problemet që kemi pasur sot është kompetenca e kryetarit të Gjykatës, që çdo 2 vjet të risistemojë gjyqtarët. Sa e parandalon ky ligj këtë lëvizje të gjyqtarëve nga një seksion në një tjetër dhe sa mundëson profilizimin dhe specializimin e tyre? Këtë kërkesë e kam edhe për nëndegët. Është pasur parasysh te nëndegët kjo gjë? Ndoshta unë e kam keqkuptuar, sepse Agnes tha se gjyqtarët në degë do të vijnë nga gjykata e rrethit gjyqësor, vetëm stafi administrativ do të jetë aty, në qoftë se e kam kuptuar saktë.

Gjithashtu, kam një pyetje për trupën, ju i quani “nëpunësit civilë gjyqësorë”. Më së fundi do të kemi një administratë profesionale, perfekte, në qoftë se do të zbatohen të gjitha kriteret që ne përcaktuam në ligj dhe i jepni rol Shkollës së Magjistraturës. Në ligj thuhet se këta duhet të kenë mbaruar arsimin e lartë juridik. Për cilin arsim flitet? Mendoni se do të kenë edhe master? Ne kemi futur provimin shtetëror në ligjin e arsimit të lartë për studentët

që mbarojnë Fakultetin e Drejtësisë. Ndërkohë, për të shkuar në Magjistraturë ka një provim tjetër, por njëkohësisht ju thoni se edhe për stafin, për nëpunësin civil gjyqësor do të ketë një provim pranimi. Jam e saktë? Kualifikimi fillestar për kancelarin, për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe për stafin tjetër do të jetë afatgjatë, apo ka një periudhë? Cila është periudha e provës që thuhet?

Ndërkohë, i keni dhënë jashtëzakonisht shumë kompetenca Këshillit të Lartë Gjyqësor, siç i takon një qeverie të gjyqësorit. Jam dakord, por si do të arrijë ta realizojë trajnimin e pjesës tjetër të stafit të gjykatave Këshilli i Lartë Gjyqësor? Do ta bëjë nëpërmjet Shkollës së Magjistraturës? Unë krijoj përshtypjen që me kaq shumë kompetenca që merr Këshilli i Lartë Gjyqësor, edhe kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të jenë shumë të forta nga vetë trupa, sidomos gjyqësore.

Gjithashtu, vlerësoj faktin që ju keni marrë në konsideratë pothuajse të gjitha rekomandimet e Këshillit të Europës, të CEPEJ-it, modelet më të mira, parimet mbi etikën e gjyqtarit dhe më vjen shumë mirë që Shqipëria do të ketë më në fund një ligj me standarde europiane. Por pyetja ime qëndron për stafin që kemi aktualisht, i cili vazhdon punën. Ka një periudhë tranzicioni, stafi vazhdon punën dhe i nënshtrohet kualifikimit. Administrata gjyqësore, që ne kemi sot, a mund t'u përgjigjet të gjitha këtyre standardeve kaq të larta që përcakton ligji "Për organizimin e sistemit gjyqësor"? A mendoni se është e mjaftueshme koha prej 2 vjetësh që është lënë për kualifikime dhe trajnime?

E fundit, pasi një sërë pyetjesh do t'i ruaj për shqyrtimin nen për nen, ju fusni konceptin e magjistratit të komanduar, i cili do të asistojë gjyqtarët në Gjykatën e Lartë dhe zëvendësin e ndihmësit ligjor të sotshëm. Pse është përdorur termi "magjistrat i komanduar"?

Në këtë kuadër, për ta mbyllur, dua të pyes: A është ligji "Për Shkollën e Magjistraturës" objekt rishikimi nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë? E bëj këtë pyetje, sepse Shkolla e Magjistraturës merr shumë kompetenca. Së fundi do të jetë në shërbim të të gjithë sistemit gjyqësor qoftë të administratës, qoftë të trupës gjyqësore.

Kur do të vijë ligji "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor"?

Duke analizuar dispozitat kalimtare dhe kohën që duhet për të bërë organizimin, mendoj se duhet të ketë një koordinim dhe duhet punuar paralel edhe për shtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare të Shkollës së Magjistraturës, sepse buxhetet për vitin e ardhshëm diskutohen dhe miratohen shumë kohë më parë. Këto ishin disa nga pyetjet që unë kisha fillimisht, pastaj kur të kalojmë në diskutimin nen për nen, kam çështje konkrete.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zonja Hysi!

Kush do të përgjigjet?

Po, fillimisht fjalën e ka zonja Bernhard.

Agnes Bernhard *-(flet anglisht)* Lidhur me pyetjen e parë, nëse degët e përkohshme nuk do të prishin solemnitetin, sigurisht ky është një aspekt që duhet marrë në konsideratë me shumë kujdes, por ka shumë shembuj në Europë, të cilët funksionojnë me këtë model. Pra, është e provuar që mund të jetë një model i sigurt, por jam dakord se duhet bërë kujdes që të garantojmë të gjitha këto parashikime.

Në lidhje me kompetencat e degëve, projektligji propozon që degët e gjykatave nuk do të merren vetëm me çështjet emergjente. Është e qartë që në Kodin e Procedurës parashikohen se cilat janë çështjet urgjente.

Ligji aktual "Për autoritetin gjyqësor" u referohet këtyre çështjeve emergjente kur vjen puna te parashikimi i kompetencave të gjyqtarëve. Nëse nuk do t'i kishim këto degë, çështjet emergjente do të merreshin parasysht vetëm nga gjykatat qendrore.

Gjithashtu, çështjet emergjente do të gjykohen vetëm nga një gjyqtar, një situatë kjo që po krijon aktualisht shumë probleme në Shqipëri, ku ka gjykata me 4 gjyqtarë, por ndodh që ka edhe gjykata, të cilat nuk kanë mjaftueshëm gjyqtarë për të krijuar një panel gjyqësor. Gjithashtu, ka çështje më specifike që kërkojnë më shumë specializim, të cilat do të gjykohen nga një panel i tretë gjyqtarësh në gjykatat më të specializuara dhe më të mëdha.

Pyetja e tretë lidhet me çështjet civile. Ideja te kjo pyetje, për ta sqaruar nëse nuk ka qenë e qartë për ju, është se degët e gjykatave do të merren me çështjet penale dhe çështjet civile, por në fushën e çështjeve civile do të përjashtohen çështjet tregtare.

Në Shqipëri ka 8 gjykata të vogla, ku sipas një raporti të Ministrisë së Drejtësisë të bërë për dy vjetët e fundit janë pasqyruar të gjitha kategoritë e çështjeve dhe numri i çështjeve që kanë dalë nga këto gjykata. Ajo që kuptuam është se në këto gjykata të vogla ka shumë pak çështje tregtare, për të mos thënë se nuk ka fare, për më tepër që çështjet tregtare janë më komplekse. Prandaj, grupi i punës mendoi që t'i përjashtonte çështjet tregtare nga kompetenca e gjykatave të degëve, por të gjitha çështjet në fushën penale të cilat gjykohen me një gjykatës do të përfshihen në fushën e kompetencave të gjykatave të degëve. Ky është arsyetimi pas të gjithë situatës.

Një pyetje tjetër kishte të bënte me specializimin e gjyqtarëve. Në fakt, projektligji përpiket të ofrojë disa udhëzime për këtë problematikë. Ai e parashikon specializimin si një nga kriteret për përcaktimin e gjyqtarëve në seksione. Është e qartë që kur një gjyqtar do të përcaktohet në një seksion, specializimi i këtij gjyqtari do të merret patjetër në konsideratë.

Së dyti, kompetenca për caktimin e këtij gjyqtari në gjykatë do të jetë e Këshillit të Lartë të Gjyqësorit pas një takimi me një grup gjyqtarësh. Pra, një gjyqtar duhet të ketë mundësi të dalë para trupit të gjyqtarëve dhe të shpjegojë se ka eksperiencë, se kërkon që të caktohet në këtë apo në atë pozicion. Më pas këto emëtime do të rishikohen çdo 2 vjet, duke marrë parasysh specializimet e gjyqtarit, normalisht edhe të grupit që përcakton pozicionet.

Në lidhje me punonjës civil gjyqësor, një nga problematikat ishte që punonjësi civil gjyqësor duhet të ketë një status më të mirë, duhet të edukohet dhe të arsimohet më mirë. Kjo është një nga arsyet, pasi është identifikuar një performancë e dobët që ka ardhur nga një përgatitje e dobët e stafit mbështetës. Ky është një rekomandim i vazhdueshëm i CEPEJ-it për Shqipërinë. Gjithashtu, kemi pasur diskutime edhe me bordin e Shkollës së Magjistraturës për këtë problematikë.

Gjithashtu, po rishikohet edhe ligji “Për Shkollën e Magjistraturës”, që ka qenë marrëveshja e parë për të cilën ramë dakord për ta sjellë këtë ligj në një linjë me ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Shqetësimi ynë për Shkollën e Magjistraturës është se ata nuk e ndjejnë se kjo shkollë duhet të marrë përgjegjësitë për trajnimin e të gjithë punonjësve civilë gjyqësorë. E panë si fushë të kompetencës së tyre të trajnojnë kancelarët dhe ndihmësit ligjorë, që është një imazh i ri që propozon ky projektligj.

Asistenti ligjor nuk ka imazhin e mëparshëm, por me parashikimin e ri është një profesionist, një jurist i mirarsimuar, i specializuar, i cili merr përgjegjësinë për vendimmarrjen në çështje standarde dhe shumë të thjeshta. Kjo vjen e bazuar në rekomandimin e CEPEJ-it, që vazhdimisht e zhvendos përgjegjësinë nga gjykatësit në punonjës të tjerë të specializuar nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, ndjek modelet në Europë, të cilat tashmë e kanë këtë imazh si, për shembull, Franca dhe Gjermania kanë asistentë ligjorë. Pra, ky është një person vendimmarrës në çështje shumë të thjeshta me një arsimim të mirë. Ky ligj e shikon këtë figurë si një mundësi dhe më pas i përket Kodit Procedural specifik për të përcaktuar pushtetin vendimmarrës për këtë figurë, pra kompetencat parashikohen në një kod specifik procedural. Këto dy kategori: punonjësi civil gjyqësor dhe kancelari, mbulohen nga Shkolla e Magjistraturës.

Për kancelarin duhet të funksionojë një kurs 3-mujor dhe pas këtij kursi, që ndiqet çdo 3 vjet nga një grup personash, ai qëndron në listëpritje për t’u caktuar kur të hapet vendi për kancelar në gjykatë.

Qasja që diskutuam ne me Shkollën e Magjistraturës për asistentët ligjorë ishte që kandidatët duhet të ndjekin një ose dy vjet një trajnim fillestar magjistratësh. Pra, nuk është një kurs i veçantë, por një trajnim 1-vjeçar në fushat që do të jenë në kompetencat e tyre.

Gjërat po diskutohen me shpresën dhe besimin që në rast se do të ketë mungesë të asistentëve ligjorë në fushën penale, atëherë ata do të trajnojnë paraprakisht një asistent ligjor. Ideja këtu është që punonjësit civilë gjyqësorë duhet të trajnohen me kurse, të cilat do të organizohen nga Këshilli i Lartë i Gjyqësorit. Prandaj, Shkolla Magjistraturës duhet të asistojë me përpunimin e kurikulës, por pesha organizmit, ndoshta së bashku me donatorët, do të mbetet në përgjegjësi të Këshillit të Lartë të Gjyqësorit. Ky është një propozim i dhënë nga Shkolla e Magjistraturës, por mendoj se do të ishte një peshë shumë e madhe në qoftë se do t'i mbulonin ata trajnimet dhe gjithçka tjetër për të gjitha kategoritë e punonjësve civilë gjyqësorë.

Pyetja tjetër ishte: a do të sigurojë ky ligj 10-vjeçar in e stafit ekzistues nëse ata i plotësojnë kriteret, apo jo? Ideja është që kryesekretarët dhe sekretarët, të cilët janë në punë prej 10 vjetësh dhe kanë demonstruar mjaftueshëm që janë të duhurit për ta bërë atë punë, kriteret e reja nuk kanë të bëjnë me këta punonjës në detyrë, por shtrihen për të ardhmen. Pra, ata që kanë 10 vjet eksperiencë pune dhe që i përmbushin kushtet nuk do të preken nga ky ligj.

Gjithashtu, përcaktohet se asistenca ligjore nuk ka status. Pra, është një përzierje e magjistratëve të urdhëruar edhe e të tjerëve për të siguruar një status dhe për të garantuar një përgatitje të mirë, në mënyrë që të ketë një standard për ndihmën ligjore. Ideja është që në të ardhmen do të ketë vetëm magjistratë të deklaruar si asistentë ligjorë, të cilët do të funksionojnë edhe në Gjykatën e Lartë.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Kalojmë te projektligji tjetër “Për statusin e gjyqtarëve”.

Po, zonja Bernhard, ju lutem!

Agnes Bernhard - *(flet anglisht)* Ky projektligj adreson problematikat kryesore që janë nxjerrë edhe në strategji. Shqetësimi është që sistemi aktual ligjor nuk ofron kushtet për procedurat objektive për caktimin, promovimin, transferimin në të gjithë zhvillimin e karrierës. Gjithashtu, edhe detyrimi disiplinor, ashtu siç është tani, nuk është mjaftueshëm i qartë për të garantuar një pastrim të sistemit. Ai adreson edhe çështje, ku skema e vlerësimit nuk rezulton të jetë e mjaftueshme, sepse rezulton që nuk ka një skemë vlerësuese aktuale shumë të mirë, prandaj të gjitha këto problematika janë adresuar këtu.

Ky projektligj është i ndarë në kapituj: kapitulli i parë “Të drejtat dhe detyrimet për gjykatësit dhe prokurorët.”

Kapitulli i dytë ‘Kriteret dhe procedurat për rekrutimin dhe emërimin e tyre’. Gjithashtu, ka një kapitull për zhvillimin, vlerësimin, transferimin, promovimin dhe

urdhërimin e magistratëve, dhe një kapitull i veçantë për kriteret dhe përgjegjësitë civile dhe penale të magistratëve.

Kapitulli i parë “Të drejtat dhe detyrimet e magistratëve” parashikon rregullat për mospërputhshmëritë e magistratëve. Dihet që çdo aktivitet politik i magistratit nuk përputhet me detyrën e tij, për më tepër ka parashikime për kufizimin e kompetencave të tyre. Pra, duhet pasur parasysh që aktivitetet tregtare të një natyre të caktuar dhe aktivitetet e tjera nuk janë të lejueshme për kapacitetin e një magistrati. Gjithashtu, nuk mund të ushtrojnë funksionin në të njëjtin vend gjyqtarët, të cilët kanë lidhje familjare apo kanë marrëdhënie të ngushta me njëri-tjetrin. Kjo ka të bëjë kryesisht me gjykatat e vogla. Gjithashtu, projektligji parashikon edhe aktivitete të tjera jashtë zyrës, pra gjykatësve nuk u lejohet që të kenë aktivitete të tjera jashtë gjykatës, pa miratimin e këshillit. Këshilli ka kriteret të caktuara kur i jep autorizimin një gjyqtari për të pasur aktivitete të tjera. Në të njëjtën kohë këtu përfshihet edhe ILDKPI-ja për të kontrolluar aktivitetin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Gjithashtu, një grup tjetër ka përcaktuar benefitet, pra skemën për pagat. Paga bazë për punonjësit civilë gjyqësorë do të rritet me 30%. Nëse flas për numra konkretë, paga minimale prej fillimit të karrierës do të jetë, pak a shumë, 2,5 herë më e lartë nga ajo çfarë ata marrin aktualisht. Gjithashtu, përcaktohen dhe benefite të tjera si: pagesa shtesë për gjyqtarët që janë në një skemë lëvizëse; mundësinë e të pasurit një shtëpi me qira kur gjyqtari nuk mund të mbulojë dot kostot që të blejë një shtëpi në zonën ku ai realizon detyrën e tij, si dhe parashikime të tjera për pensionet, sigurinë sociale e kështu me radhë për gjyqtarët dhe prokurorët. Më tej do të vazhdohet për lejet dhe mundësitë e pakësimit të përgjegjësive për gjyqtarët dhe prokurorët.

Kapitulli “Për zhvillimin e karrierës” përcakton një seksion për rekrutimin e kandidatëve për magistratëve. Sistemi aktual parashikon një mënyrë shumë standarde dhe përcakton një bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Gjyqësorit dhe me Shkollën e Magistraturës për rekrutimin e punonjësve. Gjithashtu, këshilli ka një pozicion të ri, duke parashikuar që ai bën një vlerësim para se kandidatët të kalojnë në Shkollën e Magistraturës.

Për herë të parë ligji parashikon që kandidatët në Shkollën e Magistraturës duhet të kenë të paktën 3 vjet eksperiencë pune, pra që magistratët të cilët do të emërtohen në fund do të jenë në një moshë të pjekur për t’u marrë me situata të caktuara dhe për t’u marrë me procedurat e gjykatave.

Gjithashtu, parashikohet një skemë e re për vitin e tretë të arsimit profesional, ku magistratët punojnë në gjykata dhe në zyrat e prokurorisë. Megjithatë, ky ligj sqaron se në vitin e tretë internët nuk do të funksionojnë si gjyqtarë, por do të jenë ende në trajnim dhe do

të funksionojnë vetëm nën udhëheqjen e magjistratit të tyre, të caktuar nga Këshilli i Lartë i Gjyqësorit.

Magjistratit udhëheqës, i caktuar nga Këshilli i Lartë i Gjyqësorit dhe nga Shkolla e Magjistraturës, do t'i ngarkohen disa përgjegjësi për mënyrën e edukimit dhe trajnimit të personit në trajnim, në mënyrë që të orientohet në disa kanale të caktuara.

Pas Shkollës së Magjistraturës ligji prezanton një risi të re, ku parashikon detyrimin e Këshillit të Lartë të Gjyqësorit për të emërtuar të diplomuarit brenda një muaji, duke shmangur që në të ardhmen të mos kemi magjistratë, të cilët do të figurojnë të papunë për një vit ose më shumë. Pra, ata do të emërohen brenda një muaji nëse përmbushin kërkesat e parashikuara me ligj. Paralelisht me emërimin këshilli duhet të marrë vendimin për caktimin e postit, pra nëse magjistratët do të emërohen brenda një muaji, në të njëjtën kohë ata do të kenë edhe një post të caktuar. Për aq kohë sa ka vende të lira, të diplomuarit do të caktohen në këto vende, por mund të ndodhë që të ketë më shumë të diplomuar sesa vendet e lira. Dhe në këtë rast këshilli e urdhëron këtë të diplomuar në sistemin e gjyqësorit, në Ministrinë e Drejtësisë, ose në Inspektoratin e Lartë, për shembull, dhe është detyrim që sapo të dalë vendi i lirë, atëherë personi i duhur transferohet te vendi përkatës që është i lirë.

Kapitulli tjetër i dedikohet transferimit. Principi është që kur një pozicion bëhet i lirë, në çfarëdoqë limiti, fillimisht duhet t'u ofrohet gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët tashmë janë të përcaktuar. Pra, kjo krijon një farë shtyese për gjyqtarët dhe për prokurorët që të kenë një performancë më të mirë, sepse po performuan më mirë, transferohen në një gjykatë të cilën e duan, në një fushë të cilën e duan, kur krijohet vendi i lirë. Për më tepër ligji parashikon një kriter të qartë se kur gjyqtarët mund të transferohen pa pëlqimin e tyre. Ato janë rastet e një ristrukturimi administrativ. Ndoshta mund të jetë hartimi i një ristrukturimi të ri të gjyqësorit ose kur ka mungesë të magjistratëve në një gjykatë të caktuar në mënyrë të papritur, kur kjo mungesë është e përkohshme.

Në një situatë të tillë të përkohshme ligji parashikon dy opsione. Një opsion është që gjykatësit të jenë në skemën e lëvizshme. Pra, ky ligj hap mundësinë që në Këshillin e Lartë të Gjyqësorit të kemi një numër të caktuar gjyqtarësh në skemën e lëvizshmërisë të cilët përcaktohen aty. Ata firmosin marrëveshjen që do të transferohen në cilëndo gjykatë ku ka nevojë për një kohë të gjatë apo të shkurtër. Ata paguajnë më shumë për të mbuluar kostot shtesë, por në vende të tjera ne këta i quajmë "gjyqtarë fluturues". Ata fluturojnë dhe shkojnë atje ku ka nevojë për ta. Nëse nuk ka gjyqtarë që duan të shkojnë ose të bëhen pjesë e kësaj skeme të lëvizshme, ose ka një numër të vogël gjyqtarësh në këtë skemë, atëherë projektligji parashikon një opsion të dytë që do të thotë se gjyqtarët e gjykatave me numrin më të vogël të

çështjeve, ndoshta të detyruar nga këshilli, kalojnë ose zëvendësojnë përkohësisht gjyqtarë të cilët mungojnë në gjykata të tjera. Më pas i dedikohet promovimit, përcakton numrin minimal të eksperiencës profesionale e rregulluar tashmë edhe me ligj, rrit eksperiencën minimale për kryetarët e gjykatave. Aktualisht numri minimal i viteve është 5, por tani me ndryshimin bëhet 7 vjet si eksperiencë profesionale për kryetarin e gjykatave.

Më tej përcaktohet qartë se promovimi, procedurat promovuese duhet të bazohen në rezultatet e vlerësimit të performancës. Ka shumë kandidatë që kanë pikë të larta në skemën e vlerësimit dhe atëherë ata rankohen, bëhet një listë rankimi duke pasur kritere të tjera përcaktuese.

Gjithashtu, ka parashikime për përcaktimin ose emërimin e gjyqtarëve, duke u bazuar në merita, ka parashikime për kryetarin e gjykatave. Gjithashtu, një parashikim i ri është dhe urdhërimi. Urdhërim do të thotë që gjyqtari do të jetë në periudhën e urdhërimit, në këtë parashikim, për 5 vjet. Gjatë gjithë kësaj periudhe nuk kalohen më shumë se 10 vjet nën formën urdhëruese. Gjithashtu, procedurat urdhëruese parashikohen këtu. Pra, nëse Gjykata e Lartë do të donte të kishte një magistrat ndihmës, do t'ia kalojë kërkesën Këshillit të Lartë të Gjyqësorit, i cili hap një procedurë urdhëruese dhe më pas është Gjykata e Lartë që zgjedh midis atyre që kanë aplikuar për pozicionin, përcakton ose përzgjedh ata që përkojnë me pozicionin.

Gjithashtu, projektligji parashikon dispozita se si veprohet me gjyqtarët që vijnë nga mandate të limituara ose urdhëruese, për shembull, në Gjykatën e Lartë ose pas një leje se si veprohet me ta.

Ka dhe një parashikim tjetër për emërimet dhe një kapitull të tërë për vlerësimin e performancës së magistratëve. Ky kapitull bazohet në draftin i cili është përpunuar nga grupi i punës së Ministrisë së Drejtësisë dhe nga Këshilli i Ministrave u kalua në parlament ku ka mbetur pothuajse i paprekur. Thjesht përshtat opinionet e rishikuara, përcaktimet institucionale rishikuese duke e bërë Këshillin e Lartë të Gjyqësorit përgjegjës për vlerësimin, sepse sipas mendimit të Komisionit të Venecias vlerësimi nuk duhet të bëhet nga ata që janë prokurorë, janë nën inspektim e kështu me radhë.

Më pas një kapitull tërësisht i ri është përpunuar për skemën detyruese disiplinore. Hyn në projektligj, parashikon një katalog shumë të detajuar për çështjen disiplinore, prezanton masa të mëtejshme disiplinore, sepse konsiderohet se masat aktuale disiplinore nuk janë të mjaftueshme për të përcaktuar, për të garantuar masa proporcionale mbi ose kundër gjykatësve dhe, gjithashtu, përcakton si risi një sërë procedurash, si për procedurën hetuese, me kritere të qarta për kohën kur mund të kalohet në arkiv dhe kur mund të mbyllet

një hetim, si dhe në cilat raste një hetim duhet të kalojë në një rikërkesë për përcaktimin e një mase disiplinore. Dhe risia këtu është që vendimi për t'u mbyllur, për ta kaluar në arkiv një situatë mund të apelohej nga paditësi në këshill. Pra, nuk do të injorohet asnjë lloj hetimi, sepse personi që bën kërkesën ka mundësinë për apelim.

Projektligji parashikon disa dispozita për procedurat disiplinore para këshillit, të cilat garantojnë transparencën, parimet kundërshtuese. Pra, do të jetë inspektori i lartë për të shqyrtuar akuzën. Gjithashtu, ky projektligj përmban kritere të reja dhe më të qarta se kur pezullohet një gjykatës. Ka dy kategori rastesh. Një kategori është pezullim i detyrueshëm në raste arrestesh të një gjykatësi, ndalimit të një gjykatësi. Gjykatësi automatikisht pezullohet me ligj pa mëdyshjen e këshillit për ta bërë apo jo këtë anulim. Ka raste të tjera pezulluese ku për shembull ka nisur një hetim disiplinor ose penal ndaj gjykatësit dhe kjo mund të jetë një arsye për ta pezulluar një gjykatës për aq kohë sa kriteret të përmbushen, siç parashikohen brenda vitit.

Dhe kapitulli i fundit përfshin parashikime transitore, të cilat, nëse mund t'i përmbledh, kanë një gamë të gjerë për gjyqtarët dhe prokurorët që janë aktualisht nëpër pozicionet e tyre dhe do të mbeten në pozicionet aktuale, por patjetër që do të kalojnë te sistemi i vetingut, sistemi i vlerësimit. Ka parashikime për ata të cilët janë në pozicionet zëvendësuese. Këshilli i Lartë i Gjyqësorit do të marrë vendimet përkatëse, ka parashikime për masat e sigurisë. Për shembull, kur nuk zgjidhet një situatë brenda një gjykate ajo i kalon gjykatës tjetër e kështu me radhë.

Pra, ky ishte një parashtrim i shpejtë i projektligjit që në fakt ka shumë gjëra për t'u diskutuar, por grupit të punës i është dashur që të japë një udhëzim, ose t'i hapë rrugë këshillit një rrugë transparente për të gjithë sistemin e gjyqësorit.

Fatmir Xhafaj – Falemnderit, zonja Benhard për ekspozenë lidhur me përmbajtjen e këtij projektligji tejet të rëndësishëm, për eficiencën dhe përgjegjshmërinë e sistemit! Natyrisht kjo dhe për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Kush ka pyetje nga kolegët? Po.

Ulsi Manja – Falemnderit për prezantimin! Komplimente për stafin dhe ekspertët!

Pyetja ime e parë është ndoshta e natyrës teknike. Ligji ka futur konceptin e ndihmësmagjistratit. Dhe referuar përkufizimit, pyetja ime është: me ndihmësmagjistrat bëhet fjalë për konceptin e këshilltarëve ligjorë, që janë sot pranë Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Kushtetuese e kështu me radhë? Pra, ky është koncepti i ndihmësmagjistratit, në përkufizimin që jepni ju sot?

Pyetja e dytë. U përmend se, si risi e projektligjit, janë parashikuar papajtueshmëritë ambientale të magjistratëve. Këtu i referohet faktit të marrëdhënieve familjare, që ekzistojnë në gjykata, në të njëjtën gjykatë ose edhe në prokurori. Sigurisht eksperiencia shqiptare tregon se këto marrëdhënie familjare ambientale ekzistojnë edhe brenda për brenda raportit gjykatë-prokurori. Pra, nga familjarët, bashkëshortja gjyqtare, bashkëshorti prokuror, në të njëjtin rreth gjyqësor.

Është gjetje e duhur parashikimi në këtë projektligj i shmangies së kësaj papajtueshmërie, por kjo papajtueshmëri ambientale mund të krijohet edhe pas emërimit si magjistrat. Çfarë dua të them? Sërish praktikë shqiptare është që, kanë filluar punë si magjistratë, si gjyqtarë në të njëjtën gjykatë, dhe gjatë vazhdimit të punës është krijuar lidhja familjare.

Krijimi i lidhjeve familjare ambientale pas emërimit në gjykatë apo prokurori, a është parashikuar në këtë projektligj si rast i transferimit të detyrueshëm, pa pëlqim, apo jo? Sepse në gjykatat shqiptare dhe në prokuroritë shqiptare, raste të kësaj natyre ka me dhjetëra.

Pra, a është parashikuar se si do të zgjidhet rasti kur papajtueshmëritë ambientale për shkak të lidhjeve familjare, krijohen pas emërimit si magjistrat ose si prokuror në të njëjtin rreth gjyqësor.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po. Faleminderit, zoti Manja!

Ju lutem, kush do të përgjigjet?

Agnes Bernhard – *(flet anglisht)* Në lidhje me konceptin e ndihmësmagjistratit, ai është koncept i ri dhe lidhet vetëm me këshilltarët ligjorë të Gjykatës së Lartë, Gjykatw Kushtetuese dhe Prokurorinë e Përgjithshme. Konceptit këtu është që, këta këshilltarë ligjorë duhet të jenë magjistratë, pra gjyqtarë apo prokurorë të zëvendësuar në pozicionet e tyre për pak kohë, e pastaj kthehen përsëri. Sa i takon kategorisë tjetër, asaj të këshilltarëve ligjorë, e dini se Kushtetuta parashikon se ata duhet të kalojnë në procedura rivlerësuese në procesin e vetingut, të vlerësimit. Parashikimi transitor parashikon se, nëse ata kalojnë suksesshëm vetingun, vlerësimin, këshilltarët ligjorë, të cilët nuk janë gjyqtarë, ata mund të shkojnë në një shkollë magjistrature të shkurtuar, e më pas përcaktohen si gjyqtarë e prokurorë. Ky është koncepti i ligjit.

Së dyti, në lidhje me përputhshmërinë mjedisore, projektligji u referohet të dyja situatave, ku papërputhshmëria mjedisore brenda gjykatës, juridiksionit të një gjykate, ose midis gjykatave dhe prokurorive, parashikohen të dyja këto raste, të kemi edhe rastet kur një çift përbëhet nga gjyqtarë dhe prokurorë.

Gjithashtu drafti adreson edhe çështjen kur kjo papërputhshmëri lind gjatë periudhës së funksionit. Atëherë njoftohet këshilli, dhe njëri prej tyre duhet të lëvizë, për të kaluar te gjykata më e afërt, ose duhet të bjerë dakord për këtë gjë. Nëse nuk bihet dakord për këtë gjë, duhet të vendoset me short se kush shkon ku, por ideja e anëtarëve të grupeve të punës ka rezultuar që, me kalimin e kohës njëri do të bjerë dakord. Nuk vjen puna të kalohet te shorti. Nëse kemi gjykata më të larta, këto papërputhshmëri mjedisore lindin vetëm në gjykatat me më pak se pesëmbëdhjetë gjykatës. Në Tiranë, për shembull, nuk i kemi këto raste, sepse kemi gjykata më të mëdha. Në të ardhmen, sa më të mëdha që të bëhen gjykatat, aq më pak problematike do të bëhet situata, sepse do të jetë më e lehtë për të organizuar vendimmarrjet, për të shmangur konfliktet e interesit.

Fatmir Xhafaj – Po. Faleminderit! Pyetje të tjera?

Zonja Hysi, po.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë vlerësoj përpjekjet dhe punën kolosale që është bërë për të pasur një ligj, i cili rregullon statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Duke qenë se jam relatores, një pjesë të mirë të pyetjeve do t'i lë në diskutimin nën për nen. Unë kam një pyetje lidhur me risinë që sjell projektligji për pagat dhe përfitimet e tjera financiare e shoqërore për prokurorët dhe gjyqtarët.

Në fakt, këtu në parlament, ne kemi bërë diskutime lidhur me statusin e punonjësve të policisë, pagat e tyre, sidomos për punonjës që janë të angazhuar në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit. Kemi diskutuar për pagat e gjyqtarëve, të prokurorëve, dhe gjithmonë është thënë se pagat nuk janë të mjaftueshme, prandaj dhe gjyqtarët e prokurorët janë të korruptuar.

Ndërkohë po lexoj kreun e tretë të projektligjit dhe shoh se një ndër risitë është një trajtim super i veçantë, më i veçanti që mund të kem lexuar në lidhje me trajtimin e prokurorëve e të gjyqtarëve.

Cili është modeli që është ndjekur në ofrimin e gjithë këtyre niveleve të pagave dhe të përfitimeve financiare të lehtësimit të skemës së kredisë për shtëpi, për shkollimin e fëmijëve, për bursat e shkollimit të vetë kandidatëve, të pensionit suplementar, të përfitimit maksimal nga sigurimet shoqërore, të paprekshmërisë së pagës, të pushimeve vjetore, të pushimeve të tjera, si dhe gjithçka tjetër që lidhet me sigurinë e shëndetin në punë.

Personalisht e kuptoj se ka nevojë për një trajtim me dinjitet të prokurorëve e gjyqtarëve, por me këtë lloj rregullimi që i bëjmë këtij sektori, vendosim një disbalancë me tërë pjesën tjetër të infrastrukturës në Shqipëri, duke filluar që nga Presidenti i Republikës, te

Kryeministri, te ministrat, sepse sipas kësaj logjike do të thuhet se edhe ministrat, që të mos korruptohen duhet të kenë pagë më të mirë; s'kanë pse të marrin 1 milionë lekë të vjetra. Po ashtu edhe një deputet, nuk ka pse të marrë 1 milion e 100 mijë lekë; që të mos korruptohet, le të ketë disa privilegje. Gjithnjë nëse ecim me këtë logjikë.

Nga ana tjetër, kjo lloj skeme, a u përgjigjet mundësive që të zbatohet realisht, duke pasur parasysh buxhetin, GDP-në, si dhe faktin që ne duam ta zbatojmë këtë reformë.

Faleminderit!

Agnes Bernhard – *(flet anglisht)* Faktikisht, në fund të fundit, ky është një vendim që duhet ndërmarrë nga qeveria. Është vendim i qeverisë, sepse, në fund të fundit, qeveria ka përgjegjësinë buxhetore, por pas këtij propozimi, mund të themi se po, kështu luftojmë korrupsionin. Ajo çka duhet marrë në konsideratë është edhe fakti se në një vend ku korrupsioni është kaq i lartë, duhet të paktën të fillojmë të luftojmë korrupsionin me një trupë, e cila do ta shmangë korrupsionin e para. Të paktën për ata që janë përgjegjës për të luftuar korrupsionin, dhe të cilët kanë më shumë mundësi për t'u korruptuar, kjo mendoj se është esenca në të cilën një vend sfidohet për të bërë atë hapin përpara, që ata të cilët kanë përgjegjësinë për të luftuar korrupsionin, të kenë të paktën pavarësinë financiare. Të paktën ata që janë të lidhur me luftën kundër korrupsionit të kenë pavarësinë financiare.

Gjithashtu, nëse kemi bërë një krahasim mes pagave në rajon, dhe dolëm me propozimin që përkon me pagat e magistratëve dhe gjyqtarëve në rajon. Është një argument tjetër ky. Përfitimet e ndryshme, kryesisht u bazuan në modele, të cilat vetëm gjykatat e larta i kanë aktualisht. Praktikisht kemi zgjeruar përfitimet, të cilat janë të disponueshme aktualisht për gjykatësit e gjykatave të larta, në të gjithë rangun e gjykatësve.

Gent Ibrahimi – Edhe një koment të shkurtër në lidhje me këtë. Në një farë mënyre, ky hap që është ndërmarrë në këtë projektligj në lidhje me pagat dhe përfitimet e tjera të magistratëve, është paralajmëruar që në dokumentin strategjik. Bëhet fjalë për një lloj sakrifice proporcionale që do të duhet të bëjë Shqipëria, në mënyrë që të arrijë rezultatet e kërkuara në fushën e integritetit të magistratëve. Një tjetër argument që është pasur parasysh në përcaktimin e kësaj shkalle pagash është një studim shumë interesant i para disa viteve, nga Transparency International, i cili mund të përmbledhet në një grafik. Në atë grafik, nga njëra anë jepeshin nivelet e pagave të magistratëve në vende të ndryshme, ndërsa nga ana tjetër jepej niveli i perceptimit të korrupsionit për ta, nga publiku përkatës. Vihej re një pikë thyerje në ato vende ku niveli i pagës së magistratit në ditën e parë të punës ishte diku te 1100 euro, pra në ato vende ku magistrati paguhej 1100 euro e sipër, pikërisht aty ishte edhe momenti i thyerjes në perceptimin e publikut për korrupsion. Në ato vende perceptimi i

publikut për korrupsionin e magistratëve prirej të ishte pozitiv, në kuptimin që publiku mendonte që magistratët ose ishin pak të korruptuar ose jo të korruptuar. Pra, ka edhe indikacione të tjera që tregojnë drejt një shifre konkrete, në atë shifër konkrete ka shanse që të bëhet një kthesë pozitive për sa i takon integritetit të magistratëve. Por në llogari të fundit ky është një vendim që bëhet duke pasur parasysh sa të thella janë xhepat e çdo vendi. Ekspertët bëjnë atë që mendojnë se është e përshtatshme për të arritur rezultate dhe duhet të pajtohen të dyja këndvështrimet.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Kam unë dy gjëra.

Pa dyshim jam shumë dakord me zotin Ibrahimimi që kjo ka qenë një lloj qasjeje e çështjes së forcimit të statusit dhe përfitimeve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve: shpërblimet dhe përfitimet e tjera. Nuk ka diskutim për këtë gjë dhe duhet të ecim drejt kësaj rruge. Ajo që më shqetëson në tërësi, nga një lexim akoma më i vëmendshëm i projektit është që e kemi zgjidhur shumë mirë dhe ata që kanë punuar duket që kanë qenë gjyqtarë. Janë kujdesur shumë mirë për veten e tyre për të drejtat e tyre, për pagën, për shpërblimet dhe për përfitimet. Nuk ka asgjë të keqe, por nuk është ky raporti me përgjegjësitë, me detyrimet, sepse këto përfitime, benefite u janë dhënë atyre për shkak të përgjegjësisë që kanë, të cilësisë së punës që duhet të bëjnë në kushte të caktuara. Ndërkohë, për rastet e disiplinimit, masës disiplinore reagimi që duhet të kishte do të ndihej në këtë pjesë. Kjo është shumë e rëndësishme. Nga ana tjetër një njeri që ka përfituar 20 vjet gjithë këto benefite dhe një ditë të bukur konstatohet ose largohet nga sistemi për korrupsion, fillon një pjesë të jetës normale, ndërkohë që për rreth 20 e ca vjet ka pasur përfitime që nuk i ka pasur asnjë qytetar tjetër i vendit. Sot ajo që kemi është se këta janë gjyqtarë, punojnë sa punojnë, marrin gjithë këto përfitime, bëjnë dhe korrupsion. Pastaj: po shkoj avokat apo në administratë, marr edhe një pension të parakohshëm po të jetë, pension suplementar. Gjithë shqetësimi im është: a mund të vendosim një raport më të mirë për këtë gjë? Unë qytetari, do ta bëj këtë sakrificë, që t'ia jap gjyqtarit dhe prokurorit këtë benefit të pakrahasuar me asnjë shtetas tjetër, me asnjë zyrtar tjetër në këtë vend. Jam dakord, jam një nga njerëzit që mund të them se e kam mbrojtur më me zjarr këtë gjë, që në nisje të këtij procesi, por nga ana tjetër unë që përfitoj këto gjëra, gjyqtari, prokurori duhet të kuptojë që nëse e humbet këtë status, do t'i humbasë të gjitha ato çfarë ka. Të mendohet mirë që nëse largohet, kapet qoftë edhe me dhjetë lekë të vjetra ryshfet, ai do të largohet nga sistemi, e para. Kjo është shumë e rëndësishme.

E dyta, do të humbasë shumë në jetë, minimumi ai nuk duhet të punojë më në funksione në administratën shtetërore gjithë jetën e tij, pra duhet të ndalohet nga kjo gjë. Ne duhet të kemi një raport më të mirë midis dy anëve. Duket sikur balanca anon shumë nga të drejtat, nga përfitimet. Është shumë e rëndësishme të kemi një balancë të drejtë kur të dalim përpara qytetarëve si ligjvënës dhe të themi se kemi bërë këtë gjë, po e quaj këtë hap, këtë revolucion në këtë fushë. Po ju them sot, se të gjithë mediet japim këtë lajm. Me të drejtë, nuk kam asgjë. Jam i gatshëm, unë dhe kolegët e mi të përballemi me këtë gjë, sepse e kam thënë, vazhdoj ta them, kjo është një reformë për gjyqtarët dhe për prokurorët e ndershëm të republikës, por me dy kushte që në sistem të mbeten ata që janë realisht të ndershëm dhe t'i gëzojnë ata këto privilegje.

E dyta, sistemi të jetë aq i fortë në masat e kontrollit në ekuilibrin e tij sa për çdo influencë të vogël negative të dalësh nga sistemi. Kjo gjë nuk ta jep këtë. Kjo është një vërejtje e madhe thelbësore që më shqetëson.

Aspekti tjetër që kam është ndërsa folëm pak më lart për ligjin e mëparshëm lidhur me pjesën e organizimit, degët e të tjera, të krijohet përshtypja se situata e delegimeve e të tjera është e njëjta, të krijon një gjë sikur është tjetër ligj ai dhe tjetër ky.

Elementi i tretë që kam dhe vazhdoj të insistoj: ju vazhdoni t'i qëndroni bindjes që ligji "Për Shkollën e Magjistraturës" nuk duhet të jetë pjesë në një nga këto dy ligje, sepse gjithçka ne e kemi ndërtuar mbi Shkollën e Magjistraturës, ndërkohë që çdo ndryshim që mund t'i bëhet ligjit "Për Shkollën e Magjistraturës", mund t'i bëhet me shumicë të thjeshtë, ndonjë gjë që prish ekuilibrat. Pra, ne atë që është bazamenti e kemi në një ligj të thjeshtë dhe pjesën tjetër, atë çfarë rrjedh nga kjo, e kemi në një ligj me shumicë të cilësuar. Kemi shkollën që nxjerr studentët dhe bën formimin vazhdues me ligj të thjeshtë, kurse të gjitha çështjet që lidhen me delegimin, inspektimin e të tjera, i kemi me shumicë të cilësuar. Kjo nuk bën shumë sens.

Kam edhe disa gjëra të tjera, por do t'i shikojmë nen për nen dhe nuk dua t'ju ngarkoj më shumë.

Kam edhe një gjë të fundit. Kush do të na bëjë një skemë financiare të kuptojmë këtë gjë? Një gjyqtari të Shkollës së Parë që fillon sot, sa i shkojnë përfitimet, pagat të gjitha? Kjo do të jetë një nga çështjet më të debatueshme, për fat të keq, por njëkohësisht është edhe normale, është një revolucion në sistem.

Ka një pyetje zonja Hysi që ta kompletojmë.

Vasilika Hysi - Kam një pyetje meqenëse janë të lidhura, duke marrë shkas...

Fatmir Xhafaj - Më fal!

Kini një gjë parasysh, dikush që është ekspert pranë jush, do të caktohet, sepse qeveria duhet të shprehet mbi këtë projektligj. Ky është ligj me implikime financiare dhe për sa kohë është i tillë, nuk mund ta votojë Kuvendi po nuk pati komentim me shkrim të qeverisë. Duhet që sot urgjentisht, zonja Hysi si relatores, zonja Gjonaj, apo zonja Saliu dhe këshilltarët të bëjnë kërkesën për qeverinë për ta shqyrtuar me precedencë për javën që vjen. Duhet që ekspertët, të cilët kanë punuar të ulen bashkë me ekspertët e qeverisë për të detajuar elementet. Pra, ko gjë duhet të mbahet në konsideratë.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Në fakt pyetja lidhet me këtë tabelën që sapo më erdhi, por nuk e dija që e kishit përlllogaritur. Është shumë i vështirë leximi, do të doja të kishim një tabelë më të madhe. Ne që jemi edhe me syza me numër nuk arrijmë dot ta lexojmë.

Pyetja ime ka të bëjë me faktin që sistemi i pagave që parashikohet në këtë ligj, me sa kuptoj lë mënjane pagat e gjykatave speciale. Për ata të antikorrupsionit, të kimit të organizuar, cili është niveli i pagës për ta? Do të ketë diferencim në paga lidhur me këtë kategori njerëzish? Pra, te njësitë e posaçme, te gjykatat e posaçme dhe te prokuroria e posaçme.

E dyta, meqenëse e tha kryetari, ngaqë ka një implikim financiar, unë e kam pyetjen edhe për ligjin që sapo kaluam, të dyja ligjet, ligji që diskutuam “Për organizimin” ka faturë financiare? Meqenëse do të bëhet riorganizimi, krijimi i degëve.

Fatmir Xhafaj - Do të bëhet, kur të bëhet harta.

Vasilika Hysi - Sipas Kushtetutës, nëse ka faturë...

Fatmir Xhafaj - Po, por mos e përsërit, se po e përsërite, në këtë rast përsëritja nuk është mëma e dijes, se janë të ditura.

Agnes Bernhard– *(flet anglisht)* Faleminderit për pyetjet!

Pyeta e parë e kryetarit në lidhje me efektet e korrupsionit, trajtimi i mirë i gjyqtarëve, çfarë ndodh nëse gjyqtari korruptohet edhe për 1 mijë lekë të vjetër, pasojat në një juridiksion serioz janë që fillimisht ai ka përgjegjësi penale, do të ketë përgjegjësi penale mbi aktin e tij. Efektet penale nuk parashikohen këtu, janë në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin Penal. Ky ligj bën parashikimet për detyrimet penale, vetëm idetë e detyrimeve. Akti i parë është që gjykatësi ose prokurori largohet dhe ligji paraqet qartazi që një gjykatës i larguar nuk mund të rikthehet më në sistem. Mendoj se duhet rregulluar paralelisht edhe te ligji i avokaturës, pra, për shembull, ai që është larguar nga sistemi nuk mund të punojë as si avokat për sa i përket këtij ligji, nëse kemi përsëri rastin të përjashtimit të një gjyqtari për korrupsion, ai duhet të rikthejë 50% të pagës së 2 vjetëve të fundit. Dua të

them se nëse dikush është i korruptuar, nuk është rasti i një periudhe të gjatë, sepse në një sistem funksional korrupsioni ndodh një herë dhe ai dërgohet në burg, pretendohet se do të kapet. Pra, përveç përjashtimit, ai do të kthejë dhe 50% të pagës për 2 vjetët e fundit. Domethënë, nuk mund ta heqim të gjithë, e kemi diskutuar edhe me grupet e punës në lidhje me pagën, mund të ndodhë që paga është konsumuar dhe ai mund të ketë përgjegjësi. Pra, sipas Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut një dënim nuk mund të shkojë përtej limitit minimal. Ky parashikim 50% është bazuar në sistemin e legjislacionit shqiptar, kjo është minimalja që mund të bëhet.

Në lidhje me delegimin e gjykatësve, këto ligje më nxjerrin në pah dy raste: së pari delegimin e gjyqtarëve që shkon për rastet në të gjithë vendin. Pra, le të themi se këtu gjithçka mbulohet nga organizimi i gjykatave dhe përfshin edhe degët, duke mos i konsideruar transfertat e gjykatësve nga gjykata mëmë te gjykatat e degë, sepse këto mund të jenë nevojat e gjykatave për një periudhë të caktuar. Për shembull, le të themi se një gjykatëse është larguar për një leje lindjeje të caktuar dhe për ta mbajtur lëvizshmërinë brenda sistemit duhet ta mbulojmë këtë boshllëk, na duhet një skemë e lëvizjes, që parashikohet në këtë lig, që mbulohet nga gjyqtarët e skemës lëvizëse ose gjyqtarët që transferohen në mënyrë të përkohshme në gjykata. Kjo është një nevojë në të gjitha gjykatat e Europës dhe duhet të jemi fleksibël sipas nevojave të gjykatave.

Pyetja për ligjin e Shkollës së Magjistraturës, për t'u bërë pjesë e këtij ligji, ne mendojmë se mund të jetë pjesë e ligjit qeverisës, ku ka institucione që mbulojnë seksionin përkatës, pra mund të jetë një opsion për t'u kaluar atje si kapitull i veçantë dhe për ta pasur atje brenda institucioneve gjyqësore, që mbështesin dhënien e drejtësisë.

Gent Ibrahimi – Unë do të isha dakord me komentin e zotit Xhafaj, në fakt, kjo reformë ka vënë bast të madh te Shkolla e Magjistraturës. Po ta shikoni, ajo del gjithandej, në ndërtimin e institucioneve të reja, në konsolidimin e institucioneve të vjetra, kështu që aftësia për të bërë ndryshime thelbësore te ligji i Shkollës së Magjistraturës, me një shumicë më të ulët se 3/5-at, në fakt, mund të komprometonte gjithë ngrehinën e reformës. Kështu që ne do të ishim dakord me idenë tuaj, sidoqoftë jo këtu, por te ligjet për qeverisjen.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni, zoti Manja!

Ulsi Manja – Pyetja ime konsiston në faktin se u tha që projektligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” duket më tepër si projektligj, ku janë përshkruar të drejtat që ka kjo kategori e nëpunësve publikë, por nuk shkon në ekuilibër me detyrimet që ata kanë në raport me ofrimin e këtij shërbimi që u bëjnë qytetarëve. Duke mos u nisur nga gjendja aktuale ku ndodhet sistemi, po e marr të mirëqenë që pas kësaj reforme, sistemi do të vijë në

pikën, ku do ta ofrojë me ndershmëri shërbimin ndaj publikut dhe publiku njëkohësisht do të ketë aksesin e duhur në gjykatë dhe në prokurori.

Tani, mendimi im lidhur me trajtimin financiar, sepse kolegja Hysi bëri një pyetje në lidhje me modelin që është marrë për hartimin e kësaj tablele pagash, le të themi, pa përfitimet që ofron ligji. A është normale që pushteti gjyqësor, sistemi, të trajtohet në mënyrë kaq të diferencuar nga pjesa tjetër e administratës së lartë shtetërore, duke u nisur që nga Presidenti i Republikës, legjislativi dhe burokracia tjetër shtetërore, me këtë disnivel të madh në paga? Sepse me një përlllogaritje të thjeshtë që bëj për magistratët e grupit të parë, i bie që e fillojnë karrierën në 2 vjetët e para të punës, në mos gabofsha, sepse nuk jam shumë i orientuar në matematikë, me gati 2100 euro pagën mujore dhe në vitin e 37-40 e përfundojnë me rreth 2900 euro pagën në muaj, pa përfitimet që ofron ligji lidhur me komandimet e përkohshme e gjithë të tjerat. A ju duket normale ky stad lidhur me gjendjen ekonomike dhe stadin e zhvillimit ku ndodhet shoqëria shqiptare sot? Pra, më intereson një model. Nuk po them një model i një vendi të zhvilluar të BE-së, por dua përafërsisht një model të vendeve të rajonit në raport me pagat që ofron sot sektori publik dhe privat në Shqipëri. Më intereson më tepër një model i rajonit, që e ofron cilësisht shërbimin ndaj publikut në gjykata dhe në prokurori, jo për modelet e vendeve të rajonit, ku sistemi gjyqësor ndoshta ka probleme edhe më të mëdha se në Shqipëri, po flas për një demokraci të re në rajon.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Përgjigjet, ju lutem!

Gent Ibrahimi– Në momentin që flasim, pagat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Shqipëri janë më të ulëtat në rajon, janë më të ulëta se në Kosovë, Maqedoni, pra pa dyshim që është vendi për t’i ngritur ato. Pyetja është sa ? Në mënyrë që kjo mos të shndërrohet në një lojë kungulleshkash, është mirë të kemi disa orientime dhe pyetja juaj për modelet është qasja e duhur. Pra, të kuptojmë sesi funksionon jo masa absolute e pagesës, por raporti i pagesës. Unë sapo i kërkova zonjës Agnes Bernhard, që ajo të na thotë sesi është rregulluar kjo çështje në Austri. Unë i qëndroj edhe një herë asaj që thashë pak më parë, që le të kemi një pikënisje minimaliste, studimin e *Transparency Internacional*, i cili tregon se në ato vende ku magistratët në ditën e parë të punës paguhen 1100 euro e sipër, publiku i atyre vendeve i percepton magistratët si jo të korruptuar. Pra, me sa duket, pavarësisht se kjo është një llogari e vështirë për t’u bërë, disa shifra në dispozicion i kemi.

Natyrisht, ju mund të dalloni në këtë propozim edhe një lloj korporatizmi, në qoftë se mund të përdor këtë term. Zoti Xhafaj e përmendi në fillim, se ndoshta këtu janë përfshirë

vetë gjyqtarët. Po, është e vërtetë që janë përfshirë edhe vetë gjyqtarët në përpilimin e këtij propozimi, por është një pozicion maksimalist, i cili besoj se krijon një kuadër të përshtatshëm për diskutimin e kësaj çështjeje. Unë nuk do të doja vërtet që diskutimi për këtë çështje të fillonte në pozita minimaliste. Ky është një pozicion dhe unë nuk besoj se në mënyrë realiste, dikush mendon se kjo këtu, nuk do të shkurtohet, të gjithë janë të përgatitur për këtë. Sidoqoftë, e mira është që gjithsesi ajo që do të ngelet është të jetë një regjim pagash dhe përfitimesh dinjitoz, që mundëson profesionalizëm dhe integritet.

Agnes Bernhard – (*flet anglisht*) Doja t'i jepja përgjigje pyetjes të gjithë përfshihen në skemën e pagave, edhe rastet e luftës kundër korrupsionit e kështu me radhë, Pra, janë të përfshira dhe janë pjesë e tabelës edhe rastet e situatave më të rënda, si të krimit të organizuar, luftës kundër korrupsionit,.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Ndjesë që jam ndalur dhe po i ndalemi këtij kapitulli, por, në kuadër të reformës në drejtësi, ne flasim për një sistem eficientë, efikas, por ne flasim për ekonomi gjyqësore. Nga ana tjetër, ndalemi te kjo pikë, sepse unë kam një shqetësim dhe prandaj po pyesim kaq shumë në këtë pjesë. Në Komisionin e Ligjeve ne diskutojmë edhe pagat e institucioneve të tjera të pavarura kushtetuese, si: ILDKPI-ja, Kontrolli i Lartë i Shtetit. Ne diskutojmë pagat e institucioneve të tjera. Këtë periudhë kemi pasur kërkesa edhe nga Komisioneri i Shërbimit Civil ose kemi diskutuar për pagën e Presidentit dhe në këtë kuadër, shpesh kemi parë që ka pasur një disbalancim në nivelin e pagave dhe jemi treguar të kujdesshëm që të ketë një hierarki, të ketë një strukturë. Pse e them këtë?! Unë jam dakord me zotin Ibrahim që *Transparency International* e evidenton që një nga shkaqet e korrupsionit është paga. Aty ku ka paga të mira, ka edhe më pak korrupsion. Çfarë do të thonë punonjësit e doganave dhe të tatimeve, sepse edhe aty korrupsioni është shumë i lartë?! Atëherë, për të luftuar korrupsionin në Shqipëri edhe policia do të kërkojë me të drejtë rritje të pagës, sepse edhe ata e kanë tani pagën 300-400 euro, ndërkohë që luftojnë me terrorizmin, me krimin e organizuar.

Fatmir Xhafaj – Tani po bëjmë diskutime apo çfarë? Bëj pyetje!

Vasilika Hysi – Pra, a mundemi të kemi nga grupi që ka punuar modele të strukturës së pagave midis sektorëve, duke filluar që nga Presidenti i Republikës, që është figura më e lartë, si dhe në disa sektorë të tjerë, ku korrupsioni është i pranishëm? Për shembull, në Estoni, në Gjeorgji, në Lituanë. Zonja Agnes tha se në Ballkan rrogat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve janë më të larta se në Shqipëri. Po në raport me pagat e Presidentit, të drejtuesve

të tjerë të niveleve të larta në institucionet e pavarura kushtetuese, pra si janë paga e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Ballkan?

E di çfarë merakui kam, në qoftë se do të më lejosh, se nuk dua ta kthej në formë diskutimi, që në momentin e parë që do të fillojmë debatin në media për këtë projektligj, se do të bëjmë transparencën çfarë përmban ligji, menjëherë njerëzit do të bëjnë një konotacion negativ dhe do të thonë: “Pastaj po e bëni reformën që këtyre gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar t’ua rrisni përsëri pasurinë, sepse ata nuk e kanë një pjesë të mirë të pasurisë në emër të tyre, por i kanë fshehur”. Pra, do të bëjnë lidhjen me sistemin aktual dhe jo me atë që është në perspektivë.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por ne politikanët prandaj jemi këtu për të parë drejt se nesërmas, për ta ndryshuar këtë mentalitet; për të udhëhequr dhe për të krijuar një mentalitet të ri në këtë vend. Kjo është sfida jonë. Prandaj e kemi marrë përsipër këtë reformë, ndryshe çfarë kuptimi do të kishte se çfarë do të thonë ata?! Ne jemi këtu për të menduar një hap para. Ky është roli i politikanit. Por kini parasysh një gjë: po vetingun që do të bëjmë ne?! Edhe ajo është një masë jashtëzakonisht e ashpër. Cili është proporcionaliteti? Ne po ndërmarrim disa masa radikale dhe po i shoqërojmë njëkohësisht edhe me disa masa mbështetëse. Është proporcionale kjo, por është shumë e rëndësishme marrëdhënia me qytetarin. Të ruajmë sensin e masës në këtë të drejtë që po japim në raport me çfarë jemi, krahasuar me të tjerët. Të ruajmë sensin e masës, pra të kemi një raport ndërmjet pjesës së përfitimeve të të drejtave dhe të detyrimeve e përgjegjësisë, si dhe të ruajmë një sens mase në raport me publikun dhe pritshmëritë e tij. Kjo është në radhë të parë një përgjegjësi jona shumë e madhe, pastaj e atyre që kanë punuar për muaj e muaj të tërë, sesi ta gjejmë këtë ekuilibër. Jemi ende në momentin kur, nëse ka nevojë të rregullojmë diçka, duhet ta rregullojmë. Prandaj e bëjmë këtë paraqitje në parim sot që, kur të shkojmë nen për nen, edhe ata të kenë reflektuar, edhe ne të kemi reflektuar bashkërisht. Në qoftë se ne bindemi që kjo është e drejta, duhet ta përballojmë ne me qytetarët. Prandaj kemi thënë që do të bëjmë veting të fortë me BE-në. Nuk kemi thënë kot.

Besoje se keni një koment përmbyllës!

Agnes Bernhard – *(flet anglisht)* Thjesht doja të shtoja një argument. Drafti parashikon që pagat e larta do të aplikohen vetëm pas rivlerësimit. Pra, nuk bëhet menjëherë kalimi, pra sapo të hyjë në fuqi ligji, por vetëm pasi të bëhet vetingu, rivlerësimi. Ky është një aspekt për t’u marrë në konsideratë.

Një aspekt tjetër i grupit të punës është që gjykatësit kanë mundësi shumë më limituese për të pasur pagesa jashtë zyrës. Pra, në lidhje me profesionet e tjera, ata kanë

kufizime më të mëdha, pra mbeten vetëm me atë profesion. Ndajmë shqetësimin që situata e përgjithshme duhet të balancohet, të jetë proporcionale dhe mendoj se diskutimi nen për nen mund të nxjerrë fusha, ku është e nevojshme një balancë më e mirë.

Gent Ibrahim – Në fakt, ky projektligj krijon një sistem shumë kompleks të drejtash, detyrimesh, aktorësh. Atyre që do ta zbatojnë këtë sistem, do t'u duhet të lundrojnë për vite të tëra më radhë në të dhe do ta mësojnë në vijimësi. Ju keni detyrën me të vështirë nga të gjithë se do t'ju duhet ta absorboni në harkun kohor të disa ditëve, por ajo që unë mund t'ju them në këtë moment është që ky dokument është produkt i një kërkimi serioz. Përfitoj të bëj disa falënderime të veçanta, sidomos për zonjë Bernhard, por edhe për anëtarët e tjerë të grupit. Kam frikë se kërkesën tuaj për të gjetur disa modele të raportit të pagave në vende të ndryshme do të jetë pak e vështirë për ne. Ndoshta mund ta bëjmë për rastin e Austrisë, por nuk mund të gjejmë shumë modele. Siç e thashë, në fund të fundit, kjo reformë nga ana e marketingut politik është një gjë shumë e mirë. Ky është i vetmi element i kësaj reforme që, në fakt, nuk është i mirë nga ana e marketingut politik dhe do t'ju duhet juve të bëni sakrifica.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Në qoftë se ju nuk keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar, jemi në momentin e mbylljes. Besoj se u qartësuan disa elemente që ne i kishim si pikëpyetje, ose kishim nevojë për të pasur më shumë sqarime nga autorët e tekstit. Natyrisht, kjo është sa për të filluar debati, për shkak se javën tjetër do të bëhet diskutimi në parim, pastaj do të bëhet shqyrtimi nen për nen. Kjo do të thotë se zonja Hysi do të bëhet gati sipas kalendarit, sepse nuk ka asnjë cedim nga kalendari për paraqitjen në parim, pastaj për shqyrtimin nen për nen të projektit. Nga ana tjetër, do të duhet që dy zonjat, të cilat janë në krahun tuaj, pra zonja Etilda Saliu Gjonaj dhe Klodiana Vogli (do t'jua marrim stafin, zonja Bernhard për këtë fundjavë), së pari, do të duhet të kujdesen që relacionet të kenë një standard, të kenë një gjuhë; së dyti, teksti ka ende disa fjalë anglisht. Më vjen keq t'jua them, por i ka. Kjo do të na lehtësonte ne të mos merreshim nen për nen me këto detaje, por të merreshim me thelbin e amendamenteve.

Elementi i tretë i rëndësishëm është se kjo tabela ka nevojë të jetë pak më e plotë, pra nëse ka dokumente ku jeni mbështetur, qoftë të CEPEJ-it, qoftë të analizave krahasimore që janë bërë, të mund të bashkëngjiten, që t'i kemi në dispozicion.

E katërta, ky dokument do t'u shkojë sot të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës. Edhe stafi ynë, edhe ju nuk do të lëvizni pa e çuar këtë mesazh, në mënyrë që ata ta kenë në *inbox*-et e tyre. T'u lëmë kohë që ata të japin opinione, komente apo sugjerime. E bëjmë ne këtë, se e kemi nxjerrë në *website*, por të gjithë gjyqtarët, ngaqë janë të zënë me punë, nuk e hapin *website*-in. Kështu që për të qenë maksimalisht transparentë, ne do t'ua

përcjellim këto dy projektligje sot gjyqtarëve, prokurorëve për pjesën e projektligjit për statusin, por edhe shoqërisë civile, pedagogëve, pra të gjithë atyre që kemi në rrjetin tonë.

E fundit, për ta mbyllur, ju thjesht do të asistoni, por shkresën drejtuar qeverisë do ta përgatisim, që edhe ajo të japë opinionin e saj për efekt të implikimit financiar që ka projekti.

Ditën e hënë do të fillojmë me projektligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”; do të kemi paraqitjen e relatores, pastaj shqyrtimin nën për nën të projektit. Pra, mbledhjen do ta zhvillojmë ditën e hënë, sipas kalendarit që kemi, të cilin do ta respektojmë, sepse e kemi bërë publik. Besoj se edhe ju jeni dakord për ditën e hënë në orën 10:00.

Faleminderit për kontributin, për punën e madhe, jo thjesht për prezencën, por për ndihmën që dhatë për t’u qartësuar më mirë edhe komisioni lidhur me përmbajtjen e projektligjeve!

Natyrisht që dua të falënderoj të gjithë ata që kanë punuar me këtë projekt, pra bashkëpunëtorëve tuaj, të cilët nuk mundën të ishin dot këtu, por shpresojmë të jenë në vijim!

Falënderoj edhe stafin që na mbështeti sot! Fundjavë të mbarë të gjithëve!

MBLEDHJA MBYLLET

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga staf i teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë